

Organizata turke "Mac Consulting" ka bërë një anketë për popullaritetin e presidentit të ri të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, pasi kanë kaluar 100 ditë nga inaugurimi i tij.

Në anketë drejtpërdrejt janë përfshirë 10 mijë e 800 njerëz nga 161 rajone të Turqisë nga 1 deri më 5 dhjetor. Anketa ka treguar se numri i përkrahësve të presidentit të dymbëdhjetë të Turqisë moderne, është rritur dukshëm.

Erdogan, si kandidat për president, kishte mbështetjen e 51.8 % të qytetarëve të Turqisë, derisa kjo përqindje, sipas kësaj ankete, është rritur në 70.5%./Shembulli/